



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 366/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Muhamet Rexha Kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Anita Cucoviq kandidate për deputete për Kuvendin e Republikës së Kosovës nga radhët e subjektit politik Koalicioni “Vakat”, dega në Pejë, paraqitur kundër vendimit të PZAP-it Anr 110/2014 të datës 04.06.2014, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 18.06.2014, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e pas afatshme apeli i Anita Cucoviq kandidate për deputete për Kuvendin e Republikës së Kosovës nga radhët e subjektit politik Koalicioni “Vakat”, për rishqyrtimin e vendimit Anr 110/2014 të datës 04.06.2014

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një apel me datë 17.06.2014, të parashtruar nëpërmjet postës të dorëzuar në këtë të fundit (PTK) me datë 13.06.2014 nga Anita Cucoviq kandidate për deputete për Kuvendin e Republikës së Kosovës nga radhët e subjektit politik Koalicioni “VAKAT” e cila pretendon se vendimin PZAP-it Anr110/2014 të datës 04.06.2014 e ka pranuar me datë 13.06.2014 me të cilën ankesë lidhur me vendimin në fjalë është parashtruar nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) lidhur me posterin e koalicionit Vakat me fotografi të kandidates të këtij subjekti e vendosur në objektin publik të Postës. Sipas parashtrueses së apelit ky vendim është i paligjshëm dhe është bërë shkelje e të drejtave themelore njerëzore të garantuara me Kushtetutë të Kosovës neni 24 dhe neni 31, dhe rregullat dhe procedurat e vërtetimit siç është paraparë me Rregullat dhe Procedurat të datës 17.10.2010.

PZAP-i, shqyrtoi afatshmerinë e ankesës, gjeti se:

Apeli është e pas afatshme

PZAP-i, nga shkresat e lëndës konstatoi se apeli është i pas afatshëm pasi që neni 118.4 i LZP-së parasheh që afati ligjor për parashtrimin e apelit ndaj vendimeve të PZAP-it është 24 orë nga momenti i pranimit të vendimit, ndërsa pala ankuese vendimin Anr 110/2014 të datës 04.06.2014 e ka pranuar nëpërmjet emailit me datën 04.06.2014 për çka ekziston edhe konfirmimi i palës mbi pranimin e vendimit në fjalë, ndërsa pala ankuese ka parashtruar apel me datën 13.06.2014, çka nënkupton se ka kaluar afati i parapa ligjor prej 24 orëve për tu apeluar vendimi në fjalë.

Prandaj duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 4 dhe neni 115 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me apelin e lartpërmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi .

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 366/2014 më datën 18.06.2014



Këshillë juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.